

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), si dhe nenet 57 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 09 nëntor 2012, miratoi si vijon:

RREGULLORE PËR RAPORTIMIN E BANKAVE NË BQK

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet, kushtet dhe rregullat e raportimit të bankave në BQK.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me termet e përkufizuara në Nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për bankat*).

Neni 3 Kërkesat e përgjithshme

Çdo bankë që operon në Kosovë, duhet t'i dorëzojë BQK-së raportet të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e saj financiare, administrimin dhe operacionet si dhe për të gjitha degët dhe filialet e saj jashtë Kosovës, në bazë individuale dhe të konsoliduar. Në bazë të kësaj Rregulloreje, një bankë e huaj me dy ose më shumë degë në Kosovë do t'i konsolidojë të dhënat e të gjitha degëve në një raport të vetëm. Raportet përgatiten në formularët e përpiluar nga BQK-ja të cilat mund të ndryshohen sipas nevojës.

Neni 4 Raportet e bankave dhe afatet e raportimit

1. Raportet mujore

1.1 Bankat duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas fundit të çdo muaji, raportet mujore në vijim:

- a) Bilanci i gjendjes - Formulari 1 i BQK-së
- b) Pasqyra e të ardhurave – Formulari 4 i BQK-së
- c) Klasifikimi i mjeteve dhe rezervat e kërkuara – Formulari 6 i BQK-së
- d) Llogaritja e rezervës së likuiditetit – Formulari 10 i BQK-së

- e) Mirëmbajtja e rezervave të likuiditetit – Formulari 11 i BQK-së
- f) Afatet e maturimit të zërave të bilancit të gjendjes – Formulari 12 i BQK-së
- g) Raporti mbi mjetet likuide – Formulari 14 i BQK-së
- h) Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare – Formulari 15 i BQK-së
- i) Investimet dhe plasmanët në banka dhe institucione tjera financiare – Formulari 16 i BQK-së
- j) Investimet në letrat me vlerë të qeverive – Formulari 17 i BQK-së
- k) Raporti mbi depozitat, kreditë dhe transferet elektronike – Formulari 19 i BQK-së
- l) Kapitali bazë – Raporti nga rregullorja e BQK-së mbi adekuatshmërinë e kapitalit të bankave – Formulari 21 i BQK-së
- m) Mjetet e peshuara me rrezik – Formulari 22 i BQK-së
- n) Kalkulimi i kapitalit për rrezikun operacional – Formulari 23 i BQK-së

2. Raportet tremujore

2.1 Bankat duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas fundit të çdo tremujori, raportet tremujore në vijim:

- a) Mjetet dhe detyrimet tjera – Formulari 2 i BQK-së
- b) Ndryshimet në ekuitet dhe rezerva - Formulari 3 i BQK-së
- c) Të hyrat tjera dhe shpenzimet tjera jo nga interesi – Formulari 5 i BQK-së
- d) Klasifikimi i kredive sipas sektorëve të industrisë - Formulari 7 i BQK-së
- e) Raporti i koncentrimin të rrezikut kreditor – Formulari 8 i BQK-së
- f) Kreditë e personave të ndërlidhur me bankën – Formulari 9 i BQK-së
- g) Koncentrimi i depozitave – Formulari 13 i BQK-së
- h) Pasqyra e rrjedhës së parasë – Formulari 18 i BQK-së
- i) Zërat jashtëbilancor – Formulari 20 i BQK-së
- j) Raporti i rrezikut nga normat e interesit - Burimet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dhe shfrytëzimit të fondeve – Formulari 24 i BQK-së
- k) Pozicionet në valutë të huaj – Formulari 25 i BQK-së
- l) Raporti mbi depozitin ekuivalent të kapitalit – raportohet vetëm nga degët e bankave të huaja – Formulari 26 i BQK-së

Neni 5

Raportimi i degëve të bankave të huaja për bankat mëmë

1.1 Degët e bankave të huaja përveç raporteve të kërkuara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje lidhur me aktivitetin e tyre në Kosovë, gjithashtu duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas fundit të çdo tremujori raportet financiare tremujore të bankës mëmë, si në vijim:

- a) Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit
- b) Kapitalin rregullator (fondet vetanake)
- c) Treguesin e kredive me probleme ndaj gjithsej kredive
- d) Treguesin e kredive jopërformuese ndaj gjithsej kredive
- e) Treguesin e kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta)
- f) Treguesin e shumës së rezervave për humbjet nga kreditë ndaj gjithsej kredive jopërformuese
- g) Treguesin e kthimit në mjete mesatare (KMM)
- h) Treguesin e kthimit në ekuitet mesatar (KEM)
- i) Treguesin e mjeteve likuide ndaj gjithsej mjeteve
- j) Treguesin e mjeteve likuide afatshkurtra ndaj detyrimeve afatshkurtra – deri në tre muaj

Neni 6

Raporti vjetor

1. Bankat brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar duhet t'i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor, së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm dhe letrën e menaxhmentit për vitin e kaluar financiar. Ky paragraf aplikohet për degët e bankave të huaja vetëm në rastet kur BQK-ja kërkon auditim të veçantë të pasqyrave financiare për veprimtarinë e degës në Kosovë.
2. Degët e bankave të huaja, përveç obligimit në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor të konsoliduar të bankës mëmë së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm, brenda 4 javësh nga lëshimi i tij.
3. BQK-ja në rastet kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë nga filialet e bankave të huaja të dorëzojnë raportin vjetor të konsoliduar të bankës mëmë, së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm.

Neni 7

Raportimi shtesë

BQK-ja mund të kërkojë, sipas nevojës dhe rastit, që të raportohet më shpesh ose më gjerësisht siç konsiderohet e nevojshme, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive mbikëqyrëse.

Neni 8

Detyrimet e bankave

1. Bankat duhet të dorëzojnë raportet në afatet dhe në formën e përcaktuar nga BQK-ja.
2. Raportimi nga bankat sipas kësaj rregulloreje duhet të bëhet në formë fizike dhe elektronike.
3. Shkresa përcjellëse e raporteve në formë fizike të dorëzuara në BQK duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga personi, i cili është përgjegjës për njësinë që merret me plotësimin e raporteve dhe nga drejtori menaxhues ose i autorizuar i tij.

Neni 9

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Shkeljet e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të parashikuara në nenet 58, 59, 82 dhe 105 të Ligjit për bankat.

Neni 10

Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregulla XI e BQK-së për raportimin e bankave dhe filialeve kosovare të bankave të huaja, e miratuar më 27 gusht 2009 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Gazmend Luboteni